



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 3807 / Prot.

Tiranë, më 26/4 /2022

URDHËR

Nr. 158, datë 26.4.2022

PËR

MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pikës 2, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 1.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 247, datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve””, të Urdhrit nr. 334, datë 7.10.2020, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, urdhrin të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 158, datë 16.07.2021 “Për hartimin e Planit të Integritetit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, bashkëlidhur këtij urdhri, i përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 158, datë 16.07.2021 “Për hartimin e Planit të Integritetit”, i ndryshuar me urdhrin nr. 21, datë 19.01.2022.
2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit do të caktohet: Znj. Ledina Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm i MTM-së.
3. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit, si dhe të japë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.
4. Të gjithë punonjësit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit informojnë personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit, mbi gjendjen e integritetit të institucionit, për veprime apo ngjarje që mund të ndodhin e që mund të çojnë në cenimin e integritetit të institucionit.

5. Punonjësit e Institucionit, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informacione të nevojshme për zbatimin e planit të integritetit, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloret në fuqi.
6. Së paku një herë në vit, por edhe më shpesh nëse është e nevojshme, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit është i detyruar të paraqesë tek titullari i Institucionit një raport mbi zbatimin e Planit të Integritetit.
7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit e institucionit.
8. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR



Mirela KUMBARO FURXHI